



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-020
Prishtinë, më 12 maj 2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 12 MAJ 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljević, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe dy (2) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 4 maj 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 4 maj 2015

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, e mbajtur më 4 maj 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 15 maj 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve joekzekutivë në Bordin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e të ushqyerit me qumësht gjiri,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shërbimin mjekësor emergjent,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shëndetin mendor,
7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2014,
8. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2014,
9. Shqyrtimi i raportit të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2014,
10. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2014,
11. Propozimi i GP të Listës serbe për emërimin e nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës,
12. Propozimi i GP të Listës serbe për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Kërkesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës për miratimin e pakos së projektligjeve në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Qeveria e Kosovës ka proceduar një shkresë në Kuvend nëpërmjet së cilës ka kërkuar nga Kuvendi që të miratohet pakoja e projektligjeve, që është detyrim i institucioneve të Republikës së Kosovës, e që derivon nga kërkesat e BE-së, në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Ai tha se shkresa e Qeverisë përmban 9 projektligje, që duhet të miratohen deri në fund të muajit maj 2015, por prej tyre tri (3) janë miratuar në shqyrtim të parë, në seancën plenare, të mbajtur më 7 maj 2015, si në vijim:

1. Projektligji për Avokatin e Popullit,
2. Projektligji kundër diskriminimit dhe
3. Projektligji për barazi gjinore.

Më pas, kryetari tha se gjashtë (6) projektligje, të kërkuara për miratim nga Qeveria, janë proceduar në Kuvend më 8 maj 2015, si në vijim:

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat,
2. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
3. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
4. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë e Shtetit,
5. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për përgjimin e telekomunikimeve dhe
6. Projektligji për kompensimin e viktimave të krimit.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e Qeverisë së Kosovës për miratimin e pakos së projektligjeve të lartpërmendura, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë plenare, të premten, më 18 maj 2015, me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurorinë e Shtetit,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjimin e telekomunikimeve, dhe
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kompensimin e viktimave të krimit.

2. Kërkesa për mbajtjen e një seance solemne për shënimin e 25-vjetorit të Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë se ish-kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës në Legjislaturën e vitit 1990, z. Ilaz Ramajli, ka proceduar një shkresë në Kuvend nëpërmjet së cilës ka kërkuar nga Kuvendi që të mbajë një seancë solemne më 2 korrik 2015 për ta shënuar 25-vjetorin e Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e lartshënuar, vendosi që Kuvendi më 2 korrik 2015 të mbajë seancë solemne, me këtë:

Rend dite

1. Shënimi i 25-vjetorit të Deklaratës Kushtetuese të 2 korrikut 1990.

Gjithashtu, kryetari propozoi që më 11 qershor 2015, me rastin e Ditës së Çlirimit të Kosovës, të mbahet seancë solemne me praninë e grupit muzikor të Filarmonisë së Kosovës.

Kryesia e mbështeti propozimin kryetarit të Kuvendit, ndërsa për hollësitë tjera për organizimin e seancës solemne do të vendoset në njërën nga mbledhjet e ardhshme të kryesisë.

3. Informata lidhur me kundërligjshmëritë në procesin e privatizimit të NSH “Fabrika e Amortizatorëve” në Prishtinë, në rundin 45-A të Privatizimit

Kryesia, pasi diskutoi për pikën e lartshënuar, nxori këtë:

PËRFUNDIM

Informata e Sindikatës së Pavarur të NSHG “Fabrika e Amortizatorëve në Prishtinë” lidhur me procesin e privatizimit të NSH “Fabrika e Amortizatorëve” në Prishtinë në rundin 45-A të privatizimit i dërgohet për njoftim Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri.

4. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Mal të Zi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, në këtë përbërje: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Jasmina Zhivkoviq dhe Armend Zemaj, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Visar Krasniqi, në Mal të Zi, prej datës 17-20 qershor 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit, ndërsa më pas do të rimburësohen nga Parlamenti Evropian.

5. Njoftimi i nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jasmina Zhivkoviq, për dorëheqje nga pozita e nënkryetares së Kuvendit

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit për dorëheqjen e znj. Jasmina Zhivković nga pozita e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilin e falënderoi për bashkëpunim e deritanishëm.

6. Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me buxhetin e katër (4) komunave veriore të Kosovës për vitin 2015

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka shqyrtuar buxhetet e katër (4) komunave veriore të Republikës së Kosovës për vitin 2015: Leposaviqit, Zubin-Potokut, Zveçanit dhe Mitrovicës Veriore, të riaprovuar nga kuvendet komunale të këtyre komunave më 27 prill 2015. Ai tha se këto buxhete Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka në Ministrinë e Financave, që të pasqyrohen në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Pikat shtesë:

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Rumani

Kryesia diskutoi lidhur me kërkesën për lejimin e disa deputetëve të Kuvendit për të marrë pjesë në Lutjet e Mëngjesit, që këtë vit organizohen në Rumani, por vendimmarrjen e shtyu për mbledhjen e radhës të Kryesisë.

2. Propozimi i kryetarit të Kuvendit për vazhdimin e kontratës së punës të sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit, z. Ismet Krasniqi

Kryetari i Kuvendit, pasi e vlerësoi të suksesshme punën e Administratës së Kuvendit dhe të sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit për punën e kaluar, i propozoi Kryesisë së Kuvendit që atij t'ia vazhdojë kontratën e punës.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me propozimin e lartshënuar, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Ismet Krasniqi, i vazhdohet kontrata e punës deri më 31 korrik 2018.

Të ndryshme:

Nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, e shtroi ngrit çështjen e udhëtimeve të deputetëve të Kuvendit jashtë vendit. Ai propozoi që në të ardhmen vizitat zyrtare jashtë vendit të organizohen më mirë, si dhe të formohen grupet e përhershme në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale.

Diskutimi i plotë i nënkryetarit është dhënë në transkript.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë në orën 12:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale